



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 248 Prot.
/Z

Tiranë, më 01/10/2022

URDHËR

Nr. 547 datë 10 / 10 2022

**“PËR DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE PARALAJMËRIM ME SHKRIM, PËR
NOTEREN [REDAKTUAR]”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit Nr.8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të germës “a”, “c”, “ç”, të pikës 2, pikës 4, si dhe pikës 5, të nenit 26, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ:

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.176, datë 04.05.2022 “Për fillimin e hetimit të shkeljeve disiplinore, për noteren [REDAKTUAR]”, grupi i hetimit i përbërë nga nëpunësit e Ministrisë së Drejtësisë Andi Përmeti dhe Matilda Hoxha, në datën 20.06.2022, në orën 10.30 zhvilloi seancën dëgjimore me noteren Fabiola Ismaili, në lidhje me konstatimet e realizuara në Raportin për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm nr. 2186/5 Prot., datë 30.08.2021, sipas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.315/1, datë 08.07.2021 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.315, datë 14.04.2021 “Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm pranë noterit Fabiola Ismaili”.

Hetimi i shkeljeve disiplinore, u realizua në përputhje me pikën 7, të nenit 25, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar. Raporti i hetimit, hartohet në zbatim të nenit 38, pika 3, “Dokumentacioni i hetimit”, ku përcaktohet se: *“Me përfundimin e hetimit, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë harton raportin e hetimit, i cili përmban të paktën:...a) emrin dhe mbiemrin e hartuesve të raportit; b) shkaqet për të filluar hetimin, subjektin dhe objektin e hetimit, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin për fillimin e hetimit, ndryshimin ose shtimin e objektit të hetimit;c) veprimet e kryera gjatë hetimit; ç)- përmbledhjen e deklaratave të noterit apo zëvendësnoterit përkatës dhe të personave të tjerë ose institucioneve; d) parashtrimin e fakteve të pranuar dhe të papranuara, ashtu si edhe të provave, si dhe vlerësimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre; dh) analizën ligjore të fakteve të pranuar që mbështesin përfundimin se shkelja disiplinore e pretenduar është kryer ose se hetimi duhet mbyllur; e) propozimin për mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor, ose propozimin”.*

Nga analizimi i akteve noteriale të marra në shqyrtim, është konstatuar se:

1. Duke pasur parasysh veprimtarinë delikate dhe shërbimin publik të ofruar, ku zyra e noterit duhet të jetë e përshtatshme për përmbushjen e funksionit të noterit, nga noteria [redacted] nuk është përmbushur respektimi i kërkesave të nenit 20 të Ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar si dhe pikës 11, të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.157, datë 02.06.2020 "Për miratimin e kritereve të hollësishme për mjedisin e zyrës së noterit", duke hequr çdo reklamë me shkrim apo në forma të ndryshme në tabela, në muret e zyrës ose në afërsi të saj, si dhe në xhamat e portës apo të dritareve, ofrimit prej saj të shërbimeve të tjera përveç saj titullit "Noter".
2. Në disa nga aktet noteriale nga ana e noteres Fabiola Ismaili nuk është përmbushur respektimi i kërkesave të Ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar konkretisht në përmbushje të parashikimeve ligjore të nenit 63, pika 1, germa "a", ku është përcaktuar se: "1. Noteri, përveç detyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj dhe në ligje të veçanta, kryen detyrat e mëposhtme: a) sqaron personat fizikë e juridikë, kur këta të fundit kryejnë veprime noteriale që synojnë realizimin e të drejtave dhe mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshëm për të drejtat dhe detyrat që rrjedhin prej tyre, si dhe paralajmëron për pasojat juridike që vijnë nga kryerja e veprimeve noteriale, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre nga mosdijenja e ligjit", dhe orienton në mënyrë të drejtë, të saktë dhe të qartë palët dhe i sqaron ato pra përmbush kërkesat e germës "c", pika 1, neni 63 ku është saksionuar se, "c) gjatë hartimit të një akti ose kryerjes së një veprimi noterial, noteri u bën të qartë palëve kërkesat e ligjit për rastin konkret dhe, brenda kufijve të tij, ruan si interesat e palëve dhe ato të të tretëve".
3. Në disa nga aktet noteriale nga ana e noteres [redacted] nuk është përmbushur germa "g" e nenit 105, të LPN, i ndryshuar ku është përcaktuar se: "Akti noterial përmban dokumentacionin që i bashkëlidhet aktit dhe është pjesë përbërëse e tij".
4. Në disa nga aktet noteriale nga ana e noteres [redacted] nuk është përmbushur, zbatimi i pikës 2 të nenit 111, të Ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar ku parashikohet se: "Pas marrjes së kërkesës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 3 (tre) ditëve, kontrollon ne Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe Regjistrin Kombëtar të Dëshmimeve të Trashëgimisë nëse trashëgimlënësi ka lënë një testament dhe/ose është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore apo testamentare nga ndonjë noter tjetër", si dhe të merret në konsideratë parashikimi i nenit 105 pika 2, germa "g" të Ligjit nr.110/2018, i ndryshuar ku citohet se: "...Akti noterial përmbandokumentacionin që i bashkëlidhet aktit dhe është pjesë përbërëse e tij".

Në kushtet kur në aktet dhe veprimet noteriale të hartuara/redaktuara u konstatuan shkelje të ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore që dispienojnë veprimtarinë e noterëve, grupi i hetimit, duke mbajtur në konsideratë parimin e proporcionalitetit dhe shkallën e pakujdesisë së noterit në zbatim të pikës 2/a, të nenit 26, në harmoni me pikën 5 të nenit 26, të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit, Nr.8678, datë 14.05.2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të germës "a", "o", "ç", të pikës 2, pikës 4, si dhe pikës 5, të nenit 26, të Ligjit nr.110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar,

ÛRDHËROJ:

1. Dhënie e masës disiplinore "Paralajmërim me Shkrim", noteres [REDACTED] anëtare e Degës Vendore të Noterisë Tiranë.
2. Noteria [REDACTED] të marrë të gjitha masat për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, që lidhen me ushtrimin e rregullt të veprimtarisë noteriale, sipas parashikimeve të Ligjit 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.
3. Ky Urdhër t'i njoftohet menjëherë noteres [REDACTED] Degës Vendore të Noterisë Tiranë, Dhomës Kombëtare të Noterisë.
4. Ndaj këtij urdhri, noteria mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.
5. Ky urdhër, së bashku me raportin dhe seancën me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ulsi Manja

